



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. Dok. 23.6.11-2013/14-08

IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE PËR
MARRËVESHJEN E PARTNERITETIT PUBLIKO PRIVAT
PËR ANP-ADEM JASHARI

Auditim jo statutor

Prishtinë, Mars 2016

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Artan Venhari është duke ushtruar detyrën (UD) e kreut të ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar.

Misioni ynë është “që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike”. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditimet e performancës kryhen për të vlerësuar nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit tyre janë funksionale.

Auditorit i Përgjithshëm në detyrë Artan Venhari ka vendosur në lidhje me këtë raport për “Implementimin e Rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të vitit 2010 për Marrëveshjen PPP të ANP-AJ” i cili e ka mbikëqyrur auditimin. Raporti i lëshuar është rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtoreshës Myrvete Gashi, i mbështetur nga Samir Zymeri (Udhëheqës i ekipit), dhe Arta Kryeziu (anëtare).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	i
1 Hyrje	1
2 Konkluzioni nga viti i kaluar	4
3 Të gjeturat e auditimit.....	5
4 Konkluzion	10

Lista e shkurtesave

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AK	Autoriteti Kontraktues (në rastin e ANP AJ është KPPP)
ANP AJ	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Adem Jashari
DQPPP	Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat në Kosovë
IP	Inxhinieri i Pavarur
KPPP	Komiteti për Partneritete Publiko Private (Komiteti)
LKIA	Aeroporti Ndërkombëtar i Kosovës LIMAK (LIMAK Kosovo International Airport)
MF	Ministria e Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NJMP	Njësia për Menaxhimin e Projektit
ONAC	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)
PP	Partneri Privat
PPP	Partneriteti Publiko Privat
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport i auditimit ka të bëjë me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP, në raportin e auditimit të vitit 2014 për Marrëveshjen PPP të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës-Adem Jashari. Auditimi është kryer në Ministrinë e Financave përkatësisht në Departamentin Qendror të Partneritetit Publiko Privat.

Në auditimin tonë të vitit 2014 për Kontratën/Marrëveshjen PPP të ANP-AJ kemi konkluduar se: Terminali i ri ka filluar operimin me kohë, në përputhje me Marrëveshjen PPP dhe është certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Disa mangësi janë paraqitur në raport, të cilat nëse nuk eliminohen mund të sjellin probleme serioze gjatë implementimit të Marrëveshjes PPP në vitet ardhshme. Për këto çështje i kemi dhënë 8 rekomandime kryesore Komitetit për PPP.

Pas finalizimit të Raportit tonë në gusht 2014, KPPP-ja nuk kishte mbajtur takime të rregullta, andaj ka munguar organizimi i duhur dhe plani adekuat i veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

Megjithatë KPPP me përbërje të re¹ dhe Departamenti Qendrorë për PPP kanë bërë disa veprime në drejtim të adresimit të çështjeve të dala nga raporti në vitin 2014. Prej 8 (tetë) rekomandimeve kryesore, 4 (katër) rekomandime janë adresuar, 3 (tri) janë adresuar pjesërisht dhe 1 (një) rekomandim ende nuk është adresuar.

Progres është arritur në aspektin e rregulloreve dhe në legalizimin e objektit të terminalit të ri. Terminali është funksional, i pajisur me licencë operimi dhe i legalizuar nga Ministria përkatëse. KPPP ka themeluar Njësinë për menaxhim/monitorim afatgjatë të Marrëveshjes PPP dhe janë ndjekur procedurat me rastin e nxjerrjes së rregullores së punës, mbajtjes së procesverbaleve.

Ngecje ka në përfundimin e punëve të mbetura, të cilat ndërlidhen me praninë e KFOR-it brenda pronës së ANP-AJ dhe mungon koordinimi me KFOR-in lidhur me realizimin e këtyre punëve.

Punët e mbetura nuk janë përfunduar ende dhe nuk është përcaktuar kur dhe si do të kryhen. AK/KPPP dhe Partneri Privat janë në mirëkuptim dhe janë pajtuar për të shtyrë afatin për kryerjen e punëve të mbetura derisa të krijohen mundësitë. Mirëpo nuk kanë përcaktuar plan konkret rreth realizimit të tyre. Prania e KFOR-it në pronën e ANP-AJ nuk është e koordinuar si duhet dhe nuk ka mirëkuptim për realizimin e plotë të punëve/planit të ANP-AJ. Edhe KFOR-i e ka konfirmuar këtë gjendje, duke treguar gatishmëri për negociata dhe për koordinim të veprimeve të ardhshme ndërmjet palëve, KFOR-KPPP-PP.

Prandaj ekziston progres në adresimin e rekomandimeve por ende nuk është arritur të organizohet qasje e organizuar mbi implementimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna. Andaj AK/KPPP në vazhdimësi duhet të mbikëqyrë implementimin e plotë të tyre, me theks rekomandimet numër 6, 7 dhe 8.

¹ E formuar në fillim të vitit 2015.

Organizimi dhe zotësia e Qeverisë për realizimin e Marrëveshjes PPP, mbikëqyrja rigoroze dhe profesionale është e domosdoshme për të siguruar rezultate gjatë tërë kohës së koncesionit të ANP-AJ. Që të tregohet shembull i mirë për menaxhimin e projekteve PPP në vendin tonë.

Komiteti për PPP dhe Departamenti Qendror i PPP, janë pajtuar me konkluzionet tona dhe janë zotuar se do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të implementuar plotësisht rekomandimet e mbetura.

1 Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me përcjelljen e punës, se si janë adresuar rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit të performancës për Marrëveshjen PPP të ANP-AJ të vitit 2014².

Projekti i ANP-së është ndër të parët dhe kontrata/marrëveshja më e madhe deri me tani përmes formës PPP në vendin tonë. Menaxhimi i duhur i këtij projekti mund të shërbejë si shembull për të ardhmen. Andaj ne kryem një auditim lidhur me këtë Marrëveshje.

Gjatë realizimit të këtij projekti Qeveria dhe KPPP kanë hasur në disa pengesa të cilat nuk u arrit të tejkalohen në mënyrën e duhur. Si rasti i pronës së dhënë për PP (prania KFOR-it në pronën e ANP-së), mbikëqyrja afatgjate e projektit dhe mos planifikimi i zgjerimit të kapaciteteve të ANP-së në të gjitha drejtimit (si zgjatja e pistës). Për tejkalimin e tyre kemi dhënë tetë rekomandime.

Rekomandimet tona janë dhënë në dy drejtime: *“marrja e veprimeve për projektin e ANP-AJ”* dhe *“përmirësimet për projektet e ardhshme të formës PPP”*.

Kemi analizuar arsyet lidhur me ngecjet në adresimin e rekomandimeve dhe kemi rekomanduar për trajtimin e tyre me tutje.

Po ashtu kemi vlerësuar sa ka arritur Qeveria që të mësoj nga ky projekt që ti përdor mësimet në projektet e ardhshme. Në përmbyllje të këtij auditimi është nxjerrë një konkluzion lidhur me nivelin e adresimit të rekomandimeve dhe vazhdimin e adresimit të rekomandimeve të mbetura.

² Raport i Auditimit Për Mbkëqyrjen e Implementimit të Marrëveshjes PPP të Aeroportit Nderkombëtar të Prishtinës Adem Jashari për periudhen ndertimore 2010-2013. Nr. i Dokumentit: 23.6.9-2010/2013-08

1.1 Historiku

ANP-AJ është aeroport funksional-komercial në Republikën e Kosovës. Funksionimi i tij ka filluar në vitin 1965. Prej vitit 2009 ANP është transformuar në Shoqëri Aksionare në pronësi të Qeverisë.

Në 2009 Qeveria merr vendim për Partenritet Publiko Privat për ANP-AJ. Pas zhvillimit të procedurave për Marrëveshjen PPP, në qershor 2010 shpallet si fitues Konzorciumi Limak - Aeroport de Lyon me Strukturën Kontraktuale Dizajno-Ndërto-Financo-Opero-Transfero (DNFOT), si në vijim:

- Marrëveshja e PPP me kohëzgjatje prej 20 viteve;
- Struktura e Transaksionit PPP/DNFOT, Dizajno-Ndërto-Financo-Opero dhe në fund transfero asetet Qeverisë;
- Vend i ri për Terminal me kapacitet prej 25,000m², për arsye që lidhen me vend ndërtimin e Terminalit, plani u zgjerua dhe Terminali i ri u ndërtua 42,474m², me kosto të bartur nga PP;
- Performancat e ANP-AJ do të arrijnë nivelin e kualitetit “C” sipas Asociacionit Ndërkombëtar të Transportit Ajror (IATA C);
- Fusha e shërbimeve sipas Marrëveshjes PPP të gjitha funksionet e ANP-së do ti bartë Partneri Privat, përveç Shërbimin e kontrollit ajror (SHKA) i cili do të jetë në pronësi të shtetit të Kosovës si Ndërmarrje Publike;
- Të punësuarve të ANP-AJ në datën e Marrëveshjes PPP, iu garantohet puna për tri vite me orar të plotë;
- Partneri Privat do ti paguaj Qeverisë taksën e koncesionit mesatarisht 39.42% në të hyrat bruto, e cila fillon të aplikohet nga viti i dytë me 18% dhe viti i fundit arrin në 55% e të hyrave bruto, në vitin 2012 pagesa e parë është bërë fikse;
- Partneri Privat do ti nënshtrohet sistemit tatimor të vendit;
- Pronësia e asetëve mbetet në sektorin publik, ato vetëm transferohen për shfrytëzim gjatë Marrëveshjes.

Përderisa Qeveria i bartë në vete rreziqet lidhur me shërbimin e kontrollit ajror, rregullatorin, aspektin politik, çështjen e pronës (shpronësimin), rrezikun nga forcat madhore e ndajnë së bashku.

Projekti i ANP-së është ndër të parët dhe kontrata më e madhe deri me tani përmes PPP në vendin tonë. Mbikëqyrja dhe implementimi i këtij lloji të marrëveshjeve është përvojë e re tek ne, andaj është i rëndësishëm një vlerësim i këtij procesi para se Qeveria të filloj projekte të reja të PPP.

1.2 Sistemi i PPP në Kosovë

Sistemi i PPP në Kosovë është i përcaktuar nga Ligji i PPP, Direktivat për zbatimin e ligjit, rregullorja e punës e KPPP dhe akte tjera përcjellëse siç është manuali i punës.

Komiteti për Partneritetin Publiko Privat - KPPP

Qeveria ka themeluar Komitetin për PPP³ i cili është organi më i lartë lidhur me zhvillimin dhe aprovimin e PPP-ve. KPPP e ka rolin udhëheqës për zhvillimin e politikave, projekteve dhe programeve të PPP dhe përgatit rekomandime për Qeverinë për shqyrtim dhe miratim.

Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat - DQPPP

Në kuadër të Ministrisë së Financave është themeluar Departamenti Qendror për PPP⁴ për të ndihmuar dhe këshilluar KPPP, Ministrin e Financave dhe Autoritetet e tjera Publike për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me Partneritetin Publiko Privat. Departamenti PPP për punën e tij i raporton KPPP.

Autoriteti Kontraktues - AK

AK i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në marrëveshje, duke përfshirë por pa u kufizuar, në të drejtën për inspektimin e aktiviteteve të Partnerit Privat sipas marrëveshjes si dhe për të siguruar përputhshmërinë e plotë me kushtet e marrëveshjes.

Kur KPPP vepron në cilësinë e AK për një projekt të caktuar (si në rastin e ANP AJ), procedurat mbështetëse dhe kryhen nga DQPPP.

AK i cili mund të jetë lokal apo qendror, ndër të tjera duhet të:

- Themelojë një Ekip të kualifikuar profesional për menaxhimin e kontratës, për monitorimin dhe sigurimin e zbatimit të plotë të kushteve të marrëveshjes nga partneri privat; dhe
- Sigurojë informata, të cilat kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga KPPP dhe Departamenti Qendror i PPP dhe koordinimin e aktiviteteve dhe përputhshmërisë me rregulloret e nxjerra nga KPPP si dhe sqarimet dhe udhëzimet e nxjerra nga Departamenti PPP.

Inxhinieri i Pavarur - IP

Angazhimi i IP për mbikëqyrjen e kontratës është aplikuar në Kontratën e ANP-AJ. IP ka qasje të plotë dhe është përgjegjës për implementimin e të gjitha kushteve të kontratës.

³ Ministri për Financa është anëtar i përhershëm i KPPP dhe kryesues, katër anëtarët tjerë të përhershëm të KPPP, duhet të jenë në rang të Zëvendës-Kryeministrit ose të Ministrit.

⁴ Departamenti Qendror i PPP është themeluar me Ligjin e ri të PPP, i njëjti organ ka ekzistuar edhe me ligjin e vjetër të PPP por i emërtuar si Njësia Qendrore për PPP. Në këtë raport do të referohemi vetëm si DQPPP edhe për rastet kur bëhet fjalë për NjQPPP.

2 Konkluzioni nga viti i kaluar

Ne auditimin e vitit 2014 kemi ardhur ne konkluzion që:

Terminali i ri ka filluar operimin në përputhje më Marrëveshjen PPP dhe është certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Mirëpo procesi i mbikëqyrjes së projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" kishte mangësi në implementim.

- Komiteti për PPP nuk e ka bërë delegimin e detyrave si duhet dhe nuk ka marrë të gjitha përgjegjësitë.
- Objekti i Terminalit nuk kishte leje ndërtimi.
- Njësia e përhershme për menaxhimin e projektit nuk është themeluar ende.
- Marrëveshja vazhdon të mbikëqyret nga një njësi e përkohshme për menaxhim të projektit, kjo rrezikon që Marrëveshjet PPP të dalin jashtë monitorimit të Qeverisë.

Si përfundim ishte se nëse mangësitë e vërejtura në këtë auditim nuk eliminohen, mund të sjellin probleme serioze gjatë implementimit të Marrëveshjes në vitet ardhshme. Mbikëqyrja rigoroze e profesionale nga ana e Qeverisë është e domosdoshme për të siguruar rezultate gjatë tërë kohës së koncesionit. Pasi veçori e PPP është se janë projekte afatgjate dhe zotësia e Qeverisë për administrimin e tyre është e domosdoshme.

Me qëllim të menaxhimit të sigurt të projekteve PPP, KPPP dhe DQPPP duhet të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim kërkesat ligjore dhe përveç këtyre ne kemi dhënë tetë rekomandime kryesore që ata duhet të adresojnë.

Kjo na motivoi të bëjmë një auditim/vlerësim të procesit të implementimit të rekomandimeve të dhëna për këtë projekt për të parë se si Qeveria po e mbikëqyrë Marrëveshjen PPP të ANP-AJ dhe sa është e gatshme për zhvillimin e projekteve të reja.

3 Të gjeturat e auditimit

Në vijim i kemi paraqitur konkluzionet për tetë çështjet kryesore në raportin e kaluar dhe veprimet që janë marrë për implementimin e rekomandimeve lidhur me këto çështje .

3.1 Direktivat, rregullorja e punës dhe procesverbalet e KPPP

Konkluzioni i I-rë i vitit të kaluar: Disa akte të nxjerra për implementimin e sistemit mbikëqyrës nuk janë nënshkruar dhe ka mangësi në zbatimin e tyre. KPPP ishte takuar rrallë për përcjelljen e progresit të Marrëveshjes PPP. Ekzistonte rreziku që edhe projektet tjera të përcjellën me të njëjtat dobësi dhe sistemi i dizajnuar nuk e arrin efektin e pritur. Andaj ne rekomanduam që:

- **Të gjitha procedurat administrative respektohen me rastin e nxjerrjes së direktivave, rregulloreve dhe mbajtjes së takimeve;**

Gjendja e rekomandimit 1: I adresuar

Rekomandimi i parë për direktivat, rregulloren dhe procesverbalet është adresuar. KPPP ka nxjerrë dhe nënshkruar rregulloren e re të punës. Takimet e KPPP janë mbajtur me rregull, procesverbalet e takimeve mbahen/nënshkruhen si dhe vendimet e marra janë hartuar dhe nënshkruar.

Ndërsa dy direktivat e mëhershme, janë në procedurë për nënshkrim/amandamentim nga KPPP.

Me këto veprime të KPPP bëhet formalizimi/nënshkrimi i direktivave dhe rrjedhimisht implementimi i plotë i këtij rekomandimi.

3.2 Dizajnimi i sistemit për mbikëqyrjen e projekteve të PPP

Konkluzioni i II-të i vitit të kaluar: KPPP nuk kanë siguruar formimin e NjMP-së së përhershme dhe profesionale, kjo tregon se sistemi i dizajnuar për mbikëqyrje nuk është implementuar në tërësi. Aktualisht mungesa e ekspertëve të kërkuar dhe ky lloj organizimi e ka vështirësuar mbikëqyrjen. E njëjta gjë mund të ndodhë në projektet e tilla në të ardhmen. Për të shmangur këtë gjendje tani dhe në të ardhmen, rekomanduam të sigurohet që:

- **Njësia e përhershme për menaxhimin e projektit të themelohet. Formimi i njësisë së pavarur të jetë parakusht për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve PPP;**

Gjendja e rekomandimit 2: I adresuar

Komiteti për PPP përmes vendimit ka themeluar Njësinë e Përhershme për menaxhimin e projektit (NjMP) e cila përbëhet nga pesë zyrtarë, shërbyes civil.

Në këtë vendim janë përcaktuar që Njësia do të raportojë në baza tremujore lidhur me mbikëqyrjen e Marrëveshjes PPP për ANP-AJ. Ndërsa DQPPP duhet të përgatitë termat e referencës për punën

e Njesisë dhe një pako informimi dhe trajnimi. Vendimi për NjMP është marrë pas përfundimit të punës tonë në teren andaj nuk e kemi vlerësuar për nga cilësia dhe procedurat.

NjMP ka rol të veçantë në mbikëqyrjen dhe inspektimin mbi realizimin e kontratës PPP të ANP-AJ dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

Autoriteti kontraktues⁵ siguron funksionimin e saj dhe cilësinë në mbikëqyrjen dhe inspektimin e realizimit të Marrëveshjes PPP.

3.3 Monitorimi dhe raportimi nga Njësia për Menaxhimin e Projektit (NjMP)

Konkluzioni i III-të i vitit të kaluar: Direktiva nuk ka specifikuar afatet e raportimit, dhe si rrjedhojë NjMP e përkohshme ka përgatitur vetëm tri raporte për tri vitet e periudhës së ndërtimit të Terminalit. Ndërsa KPPP është takuar rrallë për të marrë informata nëpërmjet formave të ndryshme-prezantimeve. Nëse KPPP nuk ka informata të mjaftueshme dhe me kohë vendimet e saj mund të mos jenë të duhura. Ne rekomandojmë që:

- **Komiteti për PPP të qartësoj afatet e raportimit përmes direktivave dhe rregulloreve, dhe në të ardhmen të siguroj raporte sipas kërkesave të parashkruara;**

Gjendja e rekomandimit 3: I adresuar

Ky rekomandim është adresuar përmes vendimit për themelimin e Njesisë së Përhershme për PPP. Përmes këtij vendimi është përcaktuar që Njësia të raportoj në baza tremujore tek AK-Komiteti për PPP. Ndërsa kjo rregull mund të përfshihet edhe në rregulloret/direktivat e PPP-ve.

Edhe Partneri Privat sipas Marrëveshjes PPP duhet të raportoj se paku çdo tre muaj.

Komiteti për PPP duhet të sigurohet për informim/raportim cilësor mbi ecurinë e Marrëveshjes PPP për ANP-AJ gjatë gjithë kohëzgjatjes së sajë.

3.4 Përgatitja e Marrëveshjes PPP për ANP-AJ

Konkluzioni i IV-të i vitit të kaluar: KPPP nuk ka siguruar përpilimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes PPP dhe Kontratës së IP në gjuhët zyrtare të vendit. Kjo sjellë paqartësi dhe ekziston rreziku që këto dokumentet të mos kuptohen nga zyrtarët përgjegjës për zbatimin apo monitorimin e tyre. Ne rekomandojmë që:

- **Të gjitha dokumentet zyrtare dhe Marrëveshjet të jenë në dispozicion në gjuhët zyrtare të vendit.**

⁵ Në projektin e ANP-AJ Komiteti për PPP është Autoritet Kontraktues.

Gjendja e rekomandimit 4: Pjesërisht i adresuar

Ky rekomandim është në proces të adresimit. Lidhur me Marrëveshjen PPP për ANP-AJ ky rekomandim nuk ka gjetur zbatim, për shkak se Marrëveshja bazë PPP për ANP-AJ parasheh që komunikimet të zhvillohen në gjuhën angleze. Në këtë mënyrë korrespondencat, anekset dhe çështjet që ndërlidhen me Marrëveshjen PPP për ANP-AJ janë duke u zhvilluar në gjuhën angleze.

Ndërsa Kontratat/Marrëveshjet për projekte të reja të cilat janë në proces të realizimit përmes formës PPP, janë përpiluar në gjuhët zyrtare të vendit.

Andaj është marrë në konsideratë përdorimi i gjuhëve zyrtare të vendit gjatë zhvillimit të projekteve të ardhshme përmes formës PPP.

3.5 Leja ndërtimore për Terminalin e ri

Konkluzioni i V-të i vitit të kaluar: KPPP nuk është angazhuar sa duhet për sigurimin e Lejes ndërtimore për ndërtimin e Terminalit të ri. Praktika e tillë nuk është shembull i mirë për vendin. Tash Terminali është pa leje ndërtimi dhe nëse zbatohen kërkesat ligjore për ndërtim i ekspozohet rreziqeve nga inspektorati ndërtimor. Ne rekomanduam që:

- **Mungesa e lejes ndërtimore të Terminalit të ri të trajtohet sa më parë dhe të mobilizohen akterët përgjegjës për legalizimin e objektit;**

Gjendja e rekomandimit 5: I adresuar

Lidhur me këtë rekomandim janë marrë veprime për implementimin e tij. Pasi objekti i Terminalit nuk u pajis me kohë me Lejen Ndërtimore, MMPH ka marrë veprime në vitin 2014 për legalizimin e terminalit/objektit të ANP-AJ, dhe është trajtuar si Pilot Projekt për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Komisioni i formuar për legalizim ka konstatuar se objekti i plotëson të gjitha kërkesat ligjore për tu pajisur me leje të legalizimit të kategorisë së tretë dhe i është lëshuar vendimi për Leje të Legalizimit për Terminalin e ri të ANP-AJ.

3.6 Dhënia në shfrytëzim e Pronës së ANP-së për Partnerin Privat

Konkluzioni i VI-të i vitit të kaluar: Qeveria nuk ka arritur të përmbush zotimin për dhënien e plotë të pronës në shfrytëzim për Partnerin Privat, për shkak të çështjes me KFOR-in. Çështja e pronës sjellë rreziqe të ndryshme si: mos zbatimi i plotë i planit apo ndërprerja e kontratës e cila mund të ketë kosto të lartë për vendin. Kjo mund të krijojë përshtypje për Qeverinë si partner jo të sigurt si dhe nxjerrë në pah relacionet e paqarta në mes të Qeverisë dhe KFOR-it. Ne rekomanduam që:

- **Të ndërmerren veprime të menjëhershme lidhur me kontestin e pronës me KFOR-in për qartësimin e kontestit dhe të përmyllë çështjet e hapura rreth shpronësimit të pronave**

private që të përfundoj ndërtimi i rrugës në hyrje të ANP-AJ. Për me tepër të bëhen plotësim-ndryshimet e nevojshme bazuar në kushtet e Marrëveshjes;

Gjendja e rekomandimit 6: I pa adresuar

Qeveria nuk arriti ta realizoj plotësisht zotimin e saj lidhur me pronën e dhënë në shfrytëzim PP për të ndërtuar Terminalin e ri. Ende nuk ka ndonjë veprim për mirëkuptim apo marrëveshje lidhur me praninë/koordinimin e KFOR-it në pronën e ANP-AJ. Punët e planifikuara në atë zonë ende nuk janë realizuar.

Si rrjedhojë e kësaj gjendje AK-KPPP dhe PP kanë bërë Aneks marrëveshje për zgjatjen e afatit kohor për punët e pakryera si dhe është rishikuar certifikata e pronës duke reflektuar/paraqitur praninë e KFOR-it në pronën e ANP-AJ. Me Aneks Marrëveshje PP nuk është liruar nga përgjegjësia për përfundimin e punëve të mbetura por vetëm është shtyrë afati kohor për kryerjen e tyre.

Megjithatë ende nuk është specifikuar koha dhe mënyra se si do të kryhen punët e mbetura. Ndërkohë KFOR ka treguar gatishmëri për të koordinuar veprimet e ardhshme me PP dhe KPPP.

Përveç kësaj ende nuk është përfunduar një pjesë e rrugës në hyrje të ANP-AJ edhe pse tani nuk ka pengesa pronësore brenda pronës së ANP-AJ⁶.

Andaj janë të nevojshme veprime tjera për të implementuar çështjet e ngritura dhe realizimin e plotë të punëve sipas Marrëveshjes PPP për ANP-AJ.

3.7 Kryerja e punëve ndërtimore dhe pranimi i tyre nga AK-KPPP

Konkluzioni i VII-të i vitit të kaluar: Qeveria nuk i ka pranuar ende të gjitha punët rreth Terminalit sipas Marrëveshjes PPP. Punët e pa kryera kanë ndikuar që ANP-AJ nuk e ka arritur nivelin e pritur të kapacitetit; Ne rekomanduam që:

- **Terminali i ri pranohet sipas Marrëveshjes PPP, me nivel të pritur të sigurisë dhe kapaciteteve;**

Gjendja e rekomandimit 7: Pjesërisht i adresuar

Ky rekomandim ende nuk ka gjetur adresim të plotë. Adresimi i rekomandimit është bërë edhe më i paqartë pas kërkesës nga kryesuesi i KPPP së kaluar, që certifikatat e nënshkruara të pranimit të punëve të mos bëhen të plotfuqishme deri në plotësimin e kushteve sipas bazës ligjore dhe përfundimin e punëve të mbetura.

⁶ Sipas zyrtareve të ANP-AJ "Kontrolli Ajror", tani nuk ka pengesa pronësore brenda pronës së ANP-AJ që mund të pengoj përfundimin e rrugës (në pjesën ku ka qenë parkingu i vjetër i ANP-së).

Punët e papërfunduara lidhen me pikën 4, aneksi 13 i Marrëveshjes PPP, që përfshinë: punët në zonën e sigurisë në fund të Pistës (RESA), Krahët e rrugës për akomodimin e aeroplanëve, Platforma për shkrirjen e akullit dhe Zona e improvizuar e trajnimit të zjarrfikësve.

Në pamundësi të përfundimit të këtyre punëve, KPPP me PP janë në mirëkuptim dhe në vitin 2014 janë pajtuar që disa punë të zhvendosen në pjesën tjetër të ANP-AJ. Por as kjo Marrëveshje nuk është zhvilluar.

Edhe në vitin 2015 KPPP ka nxjerrë dy Aneks Marrëveshje⁷ me PP, ku parashihet shtyrja e afatit kohor për punët e pakryera me arsyetimin e njëjtë, afërsia e zonës së KFOR-it, si dhe për shkak se është duke u planifikuar zgjatja e pistës aktuale.

Megjithatë Aneks Marrëveshjet nuk e kanë specifikuar qartë kur dhe si do të përfundojnë punët e mbetura, në mënyrë që Terminali të arrijë kapacitetet dhe sigurinë e kërkuar sipas Marrëveshjes PPP. Por ANP-AJ ka arritur të plotësojë kërkesat për certifikim nga AAC të Kosovës, andaj në vitin 2013 është certifikuar nga AAC për periudhën 5 vjeçare..

Veprimet e deritashme nuk janë të mjaftueshme për adresimin e këtij rekomandimi. Duhet të merren veprime tjera që Terminali i ri të pranohet në përputhje me kushtet e Marrëveshjes PPP, me nivel të pritur të kapaciteteve dhe të sigurisë së kërkuar me Marrëveshjen PPP.

3.8 Mbikëqyrja e punëve të pa kryera

Konkluzioni i VIII-të i vitit të kaluar: Faza ndërtimore e Projektit të ANPAJ nuk është finalizuar plotësisht siç është paraparë me Marrëveshje sepse ende nuk janë përfunduar disa pika të planit. Palët janë pajtuar për gjetjen e mënyrës për ndërtimin e këtyre 4 pikave por ende nuk ka siguri se kur do të kryhen dhe kush do të mbikëqyrë kualitetin e tyre. Andaj ekziston rreziku që punët e mbetura të mos kryhen në cilësinë e pritur. Po ashtu shërbimet e IP-së nuk janë pranuar në mënyrë formale. Ne rekomanduam që:

- **Komiteti për PPP të marr veprime lidhur me punët e mbetura duke bërë të qartë se si do të zhvillohen dhe nga kush do të mbikëqyren si dhe të hartojë një raport për shërbimet e IP nëse janë përfunduar në pajtim me Kontratën.**

Gjendja e rekomandimit 8: Pjesërisht i adresuar

Ky ndërlidhet me rekomandimin paraprak (numër 7), veprimet e KPPP kanë rezultuar me nënshkrimin e Aneks Marrëveshjeve për punët e mbetura. Ndonëse në këto Aneks marrëveshje nuk ishte e qartë se si do të zhvillohen, nga kush do të mbikëqyren këto punë po ashtu nuk ishte caktuar afati për kryerjen e punëve të mbetura.

Me gjithë këto pengesa AK/KPPP dhe PP janë në mirëkuptim dhe kanë shmangur mospajtimet.

⁷ Ankesi i parë është nxjerrë në shtator/2015 dhe në nëntor është nxjerrë Aneksi 2 i Marrëveshjes për korrigjimin, largimin e një paragrafi nga Aneksi i parë.

Ndërsa lidhur me përfundimin dhe hartimin e një raporti për pranimin e punëve të IP nuk është bërë ndonjë veprim. IP është kompani ndërkombëtare, pagesat i ka pranuar dhe mund të jetë kthyer në vendin e saj. Duhet të kihet parasysh të mos përsëriten rastet e tilla të ngjashme në projektet tjera.

Andaj nevojiten veprime shtesë të AK-KPPP dhe PP për të qartësuar aktivitetet në kuadër të dy Aneks Marrëveshjeve lidhur me mënyrën e përfundimit të punëve të mbetura.

4 Konkluzion

Komiteti dhe DQPPP kanë bërë disa veprime në drejtim të adresimit të çështjeve të dala nga raporti dhe rekomandimeve të dhëna në vitin 2014. Prej 8 (tetë) rekomandimeve kryesore, 4 (katër) rekomandime janë adresuar, 3 (tri) janë adresuar pjesërisht dhe 1 (një) rekomandim ende nuk është adresuar.

Progres është arritur në aspektin e rregulloreve dhe në legalizimin e objektit të terminalit të ri. Terminali është funksional, i pajisur me licencë operimi dhe i legalizuar nga Ministria përkatëse. KPPP ka themeluar Njësinë për menaxhim/monitorim afatgjatë të Marrëveshjes PPP dhe janë ndjekur procedurat me rastin e nxjerrjes së rregullores së punës, mbajtjes së procesverbaleve.

Ngecje ka në përfundimin e punëve të mbetura, të cilat ndërlidhen me zonën e KFOR-it brenda pronës së ANP-AJ dhe mungon koordinimi me KFOR-in lidhur me realizimin e këtyre punëve.

Punët e mbetura nuk janë përfunduar ende dhe nuk është përcaktuar kur dhe si do të kryhen. AK/KPPP dhe Partneri Privat janë në mirëkuptim dhe pajtuar për shtyrjen e afatit për kryerjen e punëve të mbetura derisa të krijohen mundësitë. Mirëpo nuk kanë përcaktuar plan konkret rreth realizimit të tyre. Punët e pakryera ndërlidhen me praninë/zonën e KFOR-it në ANP-AJ. Prania e KFOR-it në pronën e ANP-AJ nuk është e koordinuar si duhet dhe nuk ka pajtim për realizimin e plotë të punëve/planit të ANP-AJ. Edhe KFOR-i e ka konfirmuar këtë gjendje, duke treguar gatishmëri për negociata dhe për koordinim të veprimeve të ardhshme ndërmjet palëve, KFOR-KPPP-PP.

Prandaj ekziston progres në adresimin e rekomandimeve por ende nuk është arritur të organizohet qasje e organizuar mbi implementimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna. Andaj AK/KPPP në vazhdimësi duhet të mbikëqyrë implementimin e plotë të tyre, me theks rekomandimet numër 6, 7 dhe 8.

Organizimi dhe zotësia e Qeverisë për realizimin e Marrëveshjes PPP, mbikëqyrja rigoroze dhe profesionale është e domosdoshme për të siguruar rezultate gjatë tërë kohës së koncesionit. Që të tregohet shembull i mirë për menaxhimin e projekteve PPP në vendin tonë, andaj:

Rekomandojmë KPPP që të marrë veprime të nevojshme lidhur me implementimin e plotë të rekomandimeve të pa adresuara dhe pjesërisht të adresuara, si dhe të tregoj shembull të mirë për implementimin e projekteve PPP dhe mbikëqyrjen e duhur të realizimit të tyre.